

Data 16.12.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “PËRMIRËSIMI DHE ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT NË BASHKINË TIRANË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 32420000-3/32424000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,830,570.83 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pike tetëdhjetë e tre lek) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2;

***Argumentimi:** Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni*

82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

“ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

a) Standartin ISO 9001 ose ekuivalent, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

b) Standartin ISO 27001 ose ekuivalent për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

c) Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 20000-1 ose ekuivalent, për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,*

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

Si dhe mbështetur në nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

a) *ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetenca/profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente të saj ,është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) *ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me:*

- *mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.*

- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet drejtpërdrejt me detyrat e përshkruara në dokumentin e termave të referencës si:

”.....

- Integrimi i infrastrukturës së re me infrastrukturën ekzistuese.
- Instalimi dhe konfigurimi i licencës së firewall.
- Testimi i përgjithshëm i infrastrukturës dhe sistemit të sigurisë (firewall).
-

Realizimi si më sipër, kërkon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese si dhe në informacione sensitive të Institucionit, si rrjedhojë certifikimi ISO 27001 ose ekuivalenti i operatorit ekonomik është një garanci e domosdoshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që kryhen.

Akresi në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë, akresi në informacion dhe pajisjen Firewall do të jetë i kontrolluar e i monitoruar nga stafi i Bashkisë, megjithatë certifikimi ISO 27001 për operatorin ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor.

Referuar sa më sipër, disponueshmëria e certifikatës ISO 27001 ose ekuivalente, parë kjo në raport me natyrën e furnizimeve e shërbimit të kërkuar si dhe faktin e trajtimit të informacionit konfidencial gjatë implementimit të saj, kërkesa e mësipërme është një kërkesë në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet nga Autoriteti Kontraktor dhe është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

- c) Standardi ISO 20000-1 ose ekuivalent, përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të detyrave, deri në kryerjen e plotë të tyre sipas kërkesave të DST-së. Theksojmë faktin se arritja e objektivave të kontratës dhe kryerja e detyrave specifike të kërkuara, duhet të kenë në bazë të tyre një planifikim të mirëpërcaktuar dhe një realizim cilësor.

Kjo certifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT që do të realizohen përgjatë fazave të kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve me të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Distributori të autorizuar për pajisjet e ofertuara (zërat 2,12 / pika 7/ Planifikimi i Buxhetit të termave të referencës). Në

rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Argumentimi: Referuar nenit 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për elemente të rëndësishëm dhe thelbësorë të kontratës, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin ad hoc të shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për zërat e kërkuar, konkretisht (zërat 2,12 / pika 7/ Planifikimi i Buxhetit të termave të referencës), kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të pajisjeve dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të pajisjeve.

2.3.4 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, cilësinë e punës gjatë instalimit dhe konfigurimit të zërave të kërkuar si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike.

- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje switch, për të mundësuar instalimet dhe konfigurimet e switch-eve që do të lëvrohen.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente.
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit teknik për sigurimin teknik ose ekuivalente

***Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.**

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Dëshmitë/Transkriptet përkatëse/Certifikata për specialistët e kërkuar.
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi,

Kriteri 2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 41, pika 4 (i ndryshuar).

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

“licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

- a) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- b) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. ...”

- a) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike.

Kërkesa për “1 (një) specialist të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike” lidhet me praninë në stafin implementues të Operatorit, të një specialisti të sigurisë në rrjetat kompjuterike që nevojitet gjatë implementimit dhe konfigurimit të pajisjeve hardware, rrjetit LAN dhe integritetit me infrastrukturën ekzistuese aktuale të Bashkisë Tiranë, si dhe për ndërhyrjet që

mund të nevojiten përgjatë aktivizimit dhe konfigurimit të licencës për Firewall si dhe përgjatë periudhës 24 (njëzet e katër) të ofrimit të shërbimit të licensimit/abonimit.

Një punonjës i certifikuar për sigurinë në rrjet i jep siguri dhe garanci AK mbi politikat që OE duhet të ndjekë gjatë proceseve të integrimin me rrjetin aktual dhe shërbimeve objekt kontrate.

b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje switch, për të mundësuar instalimet dhe konfigurimet e switch-eve që do të lëvrohen.

Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për pajisjet switch është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me natyrën dhe objektin e prokurimit, konkretisht referuar zërit:

2. F.V Switch 24 porta i menaxhueshëm (pjesë e specifikimeve teknike)

Qëllimi i kësaj kërkesë, garanton autoritetin kontraktor që operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi teknik për të kryer detyrat specifike të projektit lidhur me konfigurimet e nevojshme dhe vendosjen në punë të pajisjeve Switch.

c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente.

Kjo kërkesë i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton realizimin e shërbimeve IT të kontratës në mënyrë të menaxhueshme në të gjithë ciklin e tyre. Duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës si edhe proceseve të shërbimit të kërkuar, kriteri i mësipërm është një indikator i rëndësishëm në cilësinë e praktikave menaxheriale të Operatorit Ekonomik.

d) Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit teknik për sigurimin teknik ose ekuivalente

Kërkesa për 1 (një) punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit teknik për sigurimin teknik ose ekuivalente, është hartuar mbështetur në nenin 7 të ligjit nr. 13/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, ku citohet se:

“...Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse...”

Kjo kërkesë është hartuar në përputhje me termat e referencës së kontratës dhe specifikimeve teknike objekt kontrate.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet që në ofertën teknike të paraqesë markën, modelin shoqëruar me katalogë ose broshura për artikujt që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta/pjeset e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve, jep mundësinë për kryerjen e verifikimeve për përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara, paraqitur nga operatorët ekonomikë, në rast se janë në përputhje me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.*

Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Qëllimi i kësaj kontrate është përmirësimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit me teknologjitë bashkëkohore si, switche, kabinet si dhe infrastruktura LAN, për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbimeve TIK ndaj përdoruesve. Për të arritur këtë qëllim duhen realizuar komponentët si më poshtë:

- Zhvillimi i infrastrukturës fizike të rrjetit, furnizim dhe vendosje për pajisjet në ambjentet e reja si: (Kabinet, switche, patch pannel, patch guide, priza muri, kabell rrjeti, kanalina plastike, patch cord, PDU, priza korrenti, rrjet elektrik, siguresa etj), sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së kontratës/kontratave.

- Licencë Antivirus, Kontroll aplikacionesh (Application Control), IPS, Filtrim Web dhe Antispam për Firewall FG200E.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Karakteristikat minimale teknike për pajisjet e kërkuara janë:

1. Kabinet rrjeti (Rack)

Lartësia e Rackut	12 U
Modeli	I pajisur me profile (shina vertikale) 19" në pjesën e përparme dhe atë të pasme. Të ketë strukturë të tillë që të lejojë aksesimin nga të gjitha anët. I lehtë për t'u zgjeruar apo për të zëvendësuar panelet. Derë në pjesën e përparme, me panele të mbyllura me mundësi hapje – mbyllje. Të katër anët e Rack-ut duhet të jenë të mbyllura me mundësi hapje – mbyllje I lyer me boje elektrostatische
Dimensionet	12U – W x D x H – 600 x 560 x 621
Tokëzimi	Automatik

Kabinet rrjeti (rack) është llogaritur për të vendosur minimalisht dy switch-e, dy patch panele dhe 2 patch guide me mundësi shtimi të këtyre pajisjeve sipas numrit mesatar të përdoruesve në një njësi shërbimi. Gjithashtu në këtë rack do të vendosen pajisjet e tjera të rrjetit, si Router, wireless modem si dhe pajisje për furnizim me korrent të pajisjeve të mësipërme.

2. Switch 24 porta i menaxhueshëm

Forma fizike	I montueshëm në Rack, 1 rack unit, aksesorët e përfshirë
Porta/Ndërfaqet	24x Porta RJ45 10/100/1G 2 x porta SFP 1 x porte console
Throughput dhe Performanca	Throughput: Min 65 mpps Kapaciteti për switchim: 90 Gbps

	Mac Address: Min 8,192 entries VLANs: Min 1024 Latency: <6µs
Memoria	Flash: 512 MB RAM: 1 GB Bufferimi i paketave 12 MB/s
Karakteristikat e shtresës L2 dhe të switchit	IEEE 802.1Q VLAN IEEE 802.3ad Link Aggregation Protocol (LACP) IEEE 802.1s MSTP (me suport edhe për standardet e vjetra IEEE 802.1d dhe IEEE 802.1w) Suport për trafik multicast me: IGMPv3 dhe MLD Paketa Jumbo IEEE 802.1AB LLDP dhe MED
Cilësia e shërbimit (QoS)	IEEE 802.1p Class of Service (CoS) Të suportojë një mekanizëm QoS që ofron: një funksion që përmban/përfshin mënyra Weighted Round-Robin si dhe një funksion për Strict Priority
Siguria	Access control lists (ACLs) per trafik IPv4 dhe IPv6 Autentifikim me IEEE 802.1X Autentifikim MAC-based RADIUS, TACACS+ SSH v2, SNMPv1/2 Port security
Menaxhimi	Menaxhim me CLI te siguruar me SSH Menaxhim WEB me HTTP TELNET/SSH SNMPv1/v2 RMON Port mirroring Local Logging & Remote Logging nëpërmjet Syslog
Karakteristikat elektrike	IEEE 802.3az Energy Efficient Ethernet
Temperatura e operimit	0°C deri ne 45°C
Garancia	Min 4 Vjet

Switch-et janë kërkuar të menaxhueshëm për të realizuar konfigurimet e nevojshme, të kërkuara nga Bashkia Tiranë si: konfigurimi i portës trunk për lejimin ose bllokimin e VLAN të ndryshem, që janë pjesë e rrjetit të Bashkisë Tiranë, menaxhimi i portave të këtij switch-i për dhënie ose bllokim aksesit në internet etj. Duhet të jenë minimalisht dy porta SFP, me qëllim lidhjen e tyre me patch cord fibër.

3. Patch Panel

Standardi ISO/IEC	Në përputhje me standardin e kategorisë 6A, Clas EA
-------------------	---

Montimi	19"
Lartësia Unit (U)	1 U
Kapaciteti	24 Porta
Numri i konektoreve (A)	24
Tipi i konektorit (A)	RJ45
Kategoria e Konektorit (A)	Cat.6A
Mbështjella e konektorit (A)	Me skermo
Lloji i modulit	Modular, i heqshem (1 nga 1)
Materiali	Metalik

Patch panelet do të përdoren për lidhjen e të gjitha portave të përdoruesve në rack. Duhet të ketë 24 porta, për të qënë të përputhshme me një switch. Portat duhet të jenë RJ45 pasi kjo është mënyra e komunikimit në Bashkinë e Tiranës. Kategoria e konektorit është CAT 6A pasi dhe kabulli i lidhjes do të jetë i kategorisë 6.

4. Sistemues Kabujsh (Patch Guide)

Lartësia ne Kabinet (U)	1 U
Lloji	Unazor
Materiali	Metalik

Patch guide duhet të jetë i montueshëm në rack. Është kërkuar për të sistemuar kabujt në rack me qëllim lehtësimin e punës për menaxhimin e tyre.

5. Prize muri RJ-45

Përshkrimi	Prizë rrjeti Rj45
Kategoria	6
Klasa dhe Kategoria e rrjetit	E / 6
Frekuenca	250MHz

Dimensione	35/18/28 mm
Karakteristika të tjera	Kuti Jashte Muri 2 Module + Tapa

Prizat e murit duhet të jenë të kategorisë 6E, pasi i tillë është dhe kabulli që do përdoret për lidhjen e përdoruesve me rack.

6. Kabëll FTP Cat.6

Ngjyra	E paspecifikuar
Klasa dhe Kategoria e rrjetit	E / 6
Frekuenca	250MHz
Diametri i përcjellësit	AwG26 ; 0.56 mm
Rezistenca	154 Ω /km
Materiali	Baker
Përdredhja e fijeve	2x2 kopjo
Materiali izolues i veshjeve	Alumin/ LSZH / Polietilen
Temperatura Operimit	-20 grade deri ne +60 grade
Rrezja e përthyerjes me ngarkesë/pa ngarkesë	≥ 70 mm ≥ 35 mm
Certifikime Standardet	EN 50173-1; EN 50288-5-1;ISO/IEC 11801; IEC 61156-5;TIA/EIA-568-B.2;IEEE 802.3at; IEC 60332-1; IEC 60754-2 ; IEC 61034

Kabulli kategoria 6E është kërkuar, pasi është i sigurtë dhe i reziston kushteve atmosferike ekstreme. Ky kabull mund të përdoret dhe për ambiente të jashtme, si dhe ruan cilësinë e transmetimit në një largësi minimumi 100 m.

7. Kanalinë Plastike me ndarje (rrjet + eletrike)

Dimensionet	150x60; 40x40; 100x60
Materiali	PVC ose ABS
Shkalla e mbrojtjes	IP40
Rezistenca mekanike	IK08
Trashësia e plastikes	3 mm
Certifikime Standartet	CEI EN 50085-2-1 ; ROHS 2 – 2011/65/CE; L.V.D 2009/95/CE

Kanalinat janë kërkuar plastike, për shkak të mënyrës së vendosjes me të lehtë. I vetmi kusht i vendosur është që të jenë me ndarje të dy rrjeteve (të dobët – Internet dhe të lartë – korrent).

8. Patch Cord-a (1 metër)

Gjatësia	1 metër
Klasa dhe Kategoria e rrjeti	E / 6
Frekuenca	250MHz
Diametri i përcjellësit	AWG26 ; 0.86mm ; 7 x 0.152
Materiali	Bakër
Materiali izolues i veshjes	LSZH
Temperatura Operimit	-20 grade deri ne +60 grade
Certifikimet	IEC 61935-2, ISO/IEC 11801:2010, REACH/SVHC

Patch cord do të shërbejnë për lidhjen e switchit me patch panelin. Teknologjia duhet të jetë CAT 6, e përputhshme me të gjitha pajisjet e tjera.

9. Priza Korenti dyshe

Prizë me dy porta	Standard Italian Shuko
Rryma	16A
Mundësi lidhje me token	Po

Portat e korentit duhet të jenë shuko, pasi të tilla janë dhe spinat e kompjuterave. Duhet të jenë 16A për të mbajtur ngarkesën e nevojshme të korrentit.

10. Kabëll korenti 3 X 4 mm

- Kabëll për transmetim energjie elektrike, i izoluar me gomë etilpropilenik me shkallë të lartë cilësie G16 që nuk lejon ndezjen e shkëndijes;
- Të jenë kablllo multipolare me përcjellës fleksibel;
- Përcjellësi të jetë baker, fleksibel, i veshur;
- Izolacioni të jetë përzirje gome etilpropilenik në temperaturë të lartë 90°C e cilësisë së lartë G16;
- Materiali mbushës të jetë jothithës i lagështirës, që nuk lejon ndezjen e shkëndijes;
- Karakteristikat teknike:
 - Tensioni nominal 0,6/1KV
 - Tansioni maksimal 1200 V
 - Temperatura e punës 90 °C
 - Temperatura në lidhje të shkurtër 250° C
 - Sforcimet maksimale për 1mm² seksioni 50N/mm² percj. Cu
 - Rrezja minimale e përthyerjes së kabullit 4 fishi i diametrit të jashtëm
- Fusha e përdorimit: Kabëll për transmetim energjie, për montim në ambiente të jashtme të lagura, për vendosje në mure e struktura metalike si dhe për shtrim nën tokë.
- Të jenë të markuara me markat e cilësisë IMQ ose CE.

Kabulli i korentit do të shërbejë për shpërndarjen e korentit nga kutia qendrore deri tek përdoruesit. Meqë lidhja do të jetë në seri, kërkohet që ky kabull të jetë i sigurt (të mos ketë rrezik zjarri dhe të durojë temperatura të larta që mund të vijnë nga tensioni i lartë) dhe i mbrojtur nga kushtet atmosferike. Ky kabull mund të përdoret si brenda kanalëve, por dhe midis mureve apo dhe lidhjeve ajrore.

11. Siguresa 16A

Ndarës qarku automatik	Fusha e përdorimit	Shpërndarje
Teknologjia e mbrojtjes	Termo magnetik	
Tensioni i lejuar	400 V	
Kapaciteti ckyçës	6 ka	
Numri i kycjeve minimale	20000 cikle	
Standartet	IEC 60529	
Rryma maksimale e lejuar	16A	

Siguresat janë kërkuar 16A për shkak të ngarkesës që do të ketë rrjeti elektrik, duke qenë se ai duhet të përballojë kompjutera, printera dhe pajisje të tjera elektronike

12. Licencë për Firewall

Nëpërmjet kësaj kontrate kërkohet të vihet në dispozicion (kur të kërkohet nga AK) licencë me afat 24 (njëzet e katër) muaj për Antivirus, Kontroll aplikacionesh (Application Control), IPS, Filtrim Web dhe Antispam për Firewall FG200E.

Bashkia Tiranë ka në përdorim pajisjen Firewall FG200E. Për të garantuar vijueshmërinë e shërbimit që ofrohen nëpërmjet kësaj pajisje është kërkuar licenca për Antivirus, Kontroll aplikacionesh (Application Control), IPS, Filtrim Web dhe Antispam për Firewall FG200E.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit në Bashkinë Tiranë”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.